



Art-Auditing , për të ndërtuar besimin!



Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

Nr 1609 prot

Tiranë më 16 shtator 2022

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Lënda: Informacion

Të nderuar përfaqësues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në zbatim të misionit tim, caktuar me vendimin Nr. 138 datë 18.03.2022, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe sipas kontratës, të lidhur mes nesh po dorëzoj dokumentacionin si vijon:

1. Partia Lëvizja e Re

- Raport Auditimi i pasqyrave financiare të fushatës së zgjedhjeve vendore pjesore të vitit 2022
- Fatura nr.116/2022 për shërbimin e auditimit

2. Partia Demokristiane e Shqipërisë

- Shkresë sqaruese nr 1609/1 prot datë 16.09.2022

Audituese Ligjore



Meri Lika

Art – Auditing

Rruga Artan Lenja, Kompleksi Magnet, Nr.184, Tiranë
Mail: merilika@outlook.com Tel: 069 20 24 448



Art-Auditing , për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

**RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR PËR FUSHATËN PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR
KRYETAR BASHKIE, 6 MARS 2022, PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA “LËVIZJA E RE”
(Hartuar sipas formatit të standartizuar nga KQZ-ja)**



Art – Auditing
Rruga Artan Lenja, Kompleksi Magnet, Nr.184, Tiranë
Mail: merilika@outlook.com Tel: 069 20 24 448



Art-Auditing , për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

A. INFORMACIONI LIGJOR

Përmbushja e detyrës sime për kryerjen e auditimit ligjor detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie 06 mars 2022, për subjektin zgjedhor, partia "Lëvizja e Re", u krye sipas vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 138, të datës 18 mars 2022 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore, si dhe kandidatët për kryetar bashkie, për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 mars 2022"

Realizimi i këtij misioni ka këtë bazë ligjore si më poshtë renditur:

i. **Kuadri ligjor**

- Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar" i ndryshuar;
- Standartet ndërkombetare të auditimit;
- Ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr.90/2017 datë 22.05.2017;
- Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,
- Vendimin nr. nr. 426, të datës 12 korrik 2021 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 06 mars 2022";
- Udhëzimit nr. 14, datë 09 qershor 2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për caktimin e kriterëve, procedurat për zgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore";
- Formatet e dokumenteve të raportimit të të ardhurave dhe shpenzimeve nga partitë të shpallura në faqen zyrtare të saj <http://kqz.gov.al/dokumentacioni/>

ii. **Standardet e kontabilitetit të zbatueshme:**

- Standartet kombëtare të kontabilitetit (SKK-të)

B. OBJEKTI I AUDITIMIT

i. **Kontrata e shërbimit**



Art-Auditing, për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

Kryerja e misionit të auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e datës 06.03.2022 u krye sipas kontratës të lidhur midis KQZ-së, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm i KQZ-së, z. Ylli MERKAJ dhe audituese ligjore, znj. Meri LIKA anëtare e IEKA-s, zotëruese e licencës së IEKA-s, me nr. 278, datë 27.08.2012, me NIPT L41528005F.

Objekti i kësaj kontrate është i përcaktuar në nenin 1 të saj dhe ka të bëjë me kryerjen e auditimit të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 06 mars 2022, nga subjektet zgjedhore (parti politike që garojnë më vete ose pjesë e një koalicioni, kandidat i propozuar nga zgjedhësit), si dhe kandidatë e listave shumëemërore në përputhje me ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, si dhe ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.

ii. Vendimi i KQZ-së

Vendimi nr. 138, datë 18 mars 2022 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që ka shpallur rezultatin e shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar (auditëve ligjorë), të cilët do të kryejnë auditimin të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 06 mars 2022, nga subjektet zgjedhore (parti politike që garojnë më vete ose pjesë e një koalicioni, kandidat i propozuar nga zgjedhësit), si dhe kandidatë e listave shumëemërore, solli lidhjen e kontratës së shërbimit, përshkruar më sipër në pikën i.

Me këtë vendim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve më ka emëruar, me cilësinë e Auditit Ligjor, të auditoj fondet e përftuara dhe të shpenzuara nga partia politike "Lëvizja e Re" gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 06 mars 2022.

iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

Përgjegjësitë e subjektit zgjedhor

Subjekti zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të të dhënave sipas formatit të standardizuar të raportimit financiar dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë lë mundur përgatitjen e raportit financiar që nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Auditimi ynë do të kryhet bazuar në faktin që drejtimi (personi përgjegjës për financat në partinë politike ose personi i përcaktuar sipas statutit të partisë), të pranojnë dhe kuptojnë se kanë përgjegjësi:

- Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të raportimeve financiare tip-standart në pajtim me kërkesat specifike të ligjit "Për partitë politike" i ndryshuar, dhe në udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së);



Art-Auditing, për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

- Për kontrollet e brendshme të atilla që drejtimi i Partisë i konsideron të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportimeve financiare tip standard të aprovuara nga KQZ-ja për fushatën zgjedhore të dt. 06 mars 2022, pa anomali materiale nga mashtrimi apo gabimi;
- Regjistrin e posaçëm, sipas formatit të miratuar nga KQZ-ja për shumën e fondeve të përfitura nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhënat që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit;
- Deklaratat e dhurimit sipas formatit të miratuar nga KQZ-ja;
- T'i japin audituesit:
 - Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet për të cilat drejtimi ka dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e raportimeve financiare tip standart, të aprovuara nga KQZ-ja për fushatën zgjedhore të dt. 06 mars 2022, siç janë regjistrimet, dokumentacioni dhe çështje të tjera;
 - Informacion shtesë, të cilin audituesi mund ta kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit dhe;
 - Të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat brenda Partisë nga të cilët audituesi e gjykon të nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit ne kërkojmë nga drejtimi i Partisë, kur është e përshtatshme, edhe nga personat e ngarkuar me administrimin që të marrim, prej tyre konfirmime me shkrim, lidhur me deklaratimet me gojë që do të na bëhen në lidhje me auditimin.

Përgjegjësitë e audituesit

Auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike. Si pjesë e një auditimi sipas SNA-ve, ne do të ushtrojmë gjykimin profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Si rrjedhojë e kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, së bashku me kufizimet e vetvetishme të kontrollit të brendshëm, ekziston një rrezik i pashmangshëm që disa nga anomalitë materiale të mbeten të pazbuluara, edhe pse auditimi është planifikuar siç duhet dhe është kryer në përputhje me SNA-të.

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare (raporti vjetor financiar) në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë por, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojë vendimet e përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Art – Auditing
Rruga Artan Lenja, Kompleksi Magnet, Nr.184, Tiranë
Mail: merilika@outlook.com Tel: 069 20 24 448



Art-Auditing , për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

C. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

Partia Lëvizja e Re është themeluar në 25 mars 2010, me vendimin e Gjykatës së Tiranës Nr. 2386. Ajo ushtron veprimtarinë e saj me numër identifikimi NIPT L91728451G. Fillimisht është identifikuar me emrin "Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë" (LDE) dhe e ka ndryshuar emrin me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 8 datë 28.12.2021 Drejtimi i sotëm i Partisë bëhet nga z. Arian Galdini.

Adresa zyrtare e selisë së Partisë është Pall.Turkeshëve në Kryqëzimin mes Rrugës "Qemal Stafa" me Rruga "Derhemi", Tiranë.

ii. Forma e organizimit dhe e menaxhimit (qendra dhe degët rajonale)

- Partia është e organizuar në strukturat e saj qendrore dhe ato vendore:
 - Kryetari
 - Kryesia

D. PARAQITJA E RAPORTIT TË AUDITIMIT DHE STRUKTURA E TIJ

i. Struktura e raportimit të auditimit, kërkesat formale, të ardhurat , shpenzimet

Partia "Lëvizja e Re" ka dorëzuar formatin e standartizuar të raportit financiar të fushatës zgjedhore, model i miratuar me vendimin nr.13, datë 06.04.2021 të Komisionit Rregullator, i shpallur dhe në faqen zyrtare të KQZ-së në këtë link: <https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/Raporti-Partia-Levizja-e-Re-2022.pdf>

Auditimi është kryer në zyrën e Auditueses Ligjore si dhe në ambientet e partisë ku është kontrolluar dhe marrë dokumentacioni, përfshirë edhe komunikimin nëpërmjet telefonit.

ii. Përmenden takimet dhe komunikimet e mundshme midis audituesit ligjor dhe subjektit zgjedhor dhe çdo person tjetër të tretë

Menjëherë pas firmosjes së kontratës me KQZ-në, nr. 2335 datë 09.05.2022, u kontaktova nga z. Arsen Lazri i cili është financieri i subjektit Lëvizja e Re. Z. Lazri vendosi në dispozicionin tim dokumentacionin e nevojshëm.

Gjatë kohës së auditimit kam qenë vazhdimisht në kontakt me e-mail me z. Lazri i cili më ka dhënë të gjitha informacionet dhe dokumentacionin që kam kërkuar.

iii. Jepet një paraqitje e përgjithshme në lidhje me raportin e financimit të fushatës zgjedhore të kontrolluar: nëse është ose jo në përputhje me kërkesat e raportimit

Art – Auditing
Rruga Artan Lenja, Kompleksi Magnet, Nr.184, Tiranë
Mail: merilika@outlook.com Tel: 069 20 24 448



Art-Auditing, për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

Raporti i financimit të fushatës nga subjekti Partia “Lëvizja e Re” është dorëzuar në datën 17 maj 2022 me nr. Prot 2400 si dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së.¹ Raporti është sipas formatit të miratuar nga KQZ. Ai përmban të gjitha të dhënat e kërkuara nga modeli i miratuar.

II. KËRKESAT FORMALE

A. PËRMBLEDHJE

1/ Data e dorëzimit			
	a) dorëzim në formë elektronike	Po	17.05.2022
	b) dorëzim fizik	Po	17.05.2022
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po	16.05.2022
3/ Llogaria bankare e veçantë / Personi përgjegjës i financës			
	a) evidenca e hapjes së llogarisë bankare	Po	Credins Bank 00001218596 ²
	b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës	Po	Është vendosur në dispozicion nga partia
	c) identiteti i personit përgjegjës të financës	Po	Personi i shpallur në KQZ si përgjegjës për financën është z. Arsen Lazri

B. ANALIZA

a/ Llogaria bankare e veçantë

o Llogaria bankare

- Partia, “Lëvizja e Re”, nuk ka hapur një llogari bankare për fushatën zgjedhore dhe për të marrë donacione që kalojnë shumën 50,000 lekë.
- Në faqen zyrtare të KQZ-së nuk është shpallur informacioni në lidhje me numrin e llogarive për fushatën zgjedhore të vitit 2022,
- Nuk ka deklarime bankare të tjera që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.
- Nga shqyrtimi i raportit të financimit të fushatës zgjedhore rezulton që nuk ka deficit dhe është i balancuar.

¹ <https://kqz.gov.al/raportet-e-subjekteve-zgjedhore-per-fushaten-zgjedhore-2022/>

² Kjo llogari u mor si dokument i skanuar nga LRE si dhe u verifikua në faqen e KQZ-së

- Plotësia e informacionit
 - Nuk është hapur llogari e veçantë për fushatën

b/ Personi përgjegjës për financën/financieri

- Identiteti i personit përgjegjës për financën (financieri):
 - Personi përgjegjës i financave është z.Arsen Lazri
- Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:

Raporti financiar i fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë me 25.04.202 , dorëzuar në KQZ është firmosur nga z. Kryetari i partisë z. Arian Galdini”.

a) bosh/mungon informacioni	Jo	Nuk mungon informacioni	
b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
	Të Ardhurat		
		Financime publike	
		Donacione private	30.000
		Financim nga burimet e veta të partisë	
		Huatë/Kreditë	
	Shpenzimet		
		Mitingjet/tubime dhe aktivitete në fushatë	
		Materialet promocionale	
		Media	
		Media Sociale	
		Sondazhe	
		Botime/Publikime	
		Shpenzime zyre elektorale	
		Transporti	
		Konsulenca	-
		Reklamime në natyre	20.000
		Shpenzime administrative	10.000



Art-Auditing , për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

III. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

	Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi publik		
0	Fondi i marrë paradhënie	0
	Data e marrjes së fondit	
	Kompensimi financiar paszgjedhor	0
	Data e marrjes së kompensimit financiar pas zgjedhor	
	Diferenca e kthyer	0
	Data e kthimit të diferencës	
2/ Donacionet private		
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0
	Shuma e donacioneve në para	0
	Shuma e donacioneve në natyrë	30.000
	Përgatitet një listë e donatorëve	Po
	Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme (bank statement)	Po
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (shuma)	Po
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)	Po
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori)	Po
	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)	Po
	A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?	Po
	Respektimi i kufirit të donacionit	Po
3/ Financimi nga burimet e vetë partisë		
	Shuma e përgjithshme e raportuar	
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)	
	Kuotat e anëtarësisë	
	Botimet	
	Shtypi i printuar	

Art – Auditing
Rruga Artan Lenja, Kompleksi Magnet, Nr.184, Tiranë
Mail: merilika@outlook.com Tel: 069 20 24 448



Art-Auditing , për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

	<i>Shitja e publikimeve</i>		
	<i>Dhënia me qira</i>		
	<i>Interesat</i>		
	<i>Transfertë nga llogaritë e partisë</i>	-	-
	<i>Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)</i>	-	-
	<i>Botimet</i>	-	-
	<i>Shtypshkronja</i>	-	-
	<i>Dhënie me qira</i>	-	-
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(shuma)	-	-
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)		-
4/ Huatë/Kreditë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)	0	0
	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)	-	-
	Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)	-	-
5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave			
Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.			

B. ANALIZA

a/ Financimi publik

- Shuma dhe data e transferimit të pagesave paradhënie dhe paszgjedhore të marra nga shteti: çfarë ndodh nëse pjesa e caktuar publike që duhet ndarë pas zgjedhjeve nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet zgjedhore → që do të thotë se raporti i financimit të fushatës zgjedhore (dhe llogaria bankare) është në deficit (kundrejt standardeve të kontabilitetit?) Raporti financiar i deklaruar nga Partia “Lëvizja e Re” nuk përmban të ardhura të përfituara nga fondet publike.
- Kontrolli i minutazhit që subjekti zgjedhor ka marrë nga çdo sektor i medias që siguron kohë të lirë transmetimi. Nuk ka paregullsi
- Rasti/et e abuzimit/keqpërdorimit të burimeve publike, që janë burimet e siguruara nga shteti, përveç hapësirës së lirë të reklamave dhe kohës së lirë të transmetimit (do të trajtohen më me hollësi në pjesën e shpenzimeve). Nuk ka raste abuzimi apo keqpërdorimi të fondeve publike.

b/ Financimi nga burimet jo publike:



Partia "Lëvizja e Re" ka krijuar të ardhura në natyrë nga fonde jo publike, të cilat në mënyrë analitike janë si vijon:

E ARDHURA	SHUMA
Hartim fletëpalosje	20.000
Dhënie hapësirë për takim	10.000
TOTALI	30.000

- **Donatorët e lejuar:**

- o Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar;
- o Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror dhe nga një degë e Partisë;

Partia "Lëvizja e Re" ka pasur dy financim donacioni nga burime jo publike në fushatën zgjedhore të datës 06 mars 2022.

Deklarimi i këtij donacioni është bërë sipas formatit të miratuar nga KQZ me vendimin nr.13 datë 06.04.2021.

Në të janë të qartë identiteti i plotë i dhuruesit, vlera në lekë e donacionit, numri identifikues i dhuruesit, data e donacionit si dhe destinacioni i përdorimit të tyre duke qenë se donacionet janë në natyrë. (raport ky i paraqitur me pasqyrat financiare të depozituara në KQZ si dhe bashkëngjitur këtij raporti).

Ky donacion ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 92/1 paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në të të cilit përcaktohet se "... shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët e tij, nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë, ose kundërvlera në zende ose shërbime...".

- **Burimet e palejuara**

Partia "Lëvizja e Re" nuk ka pasur burime të palejuara në fushatën zgjedhore të datës 06 mars 2022.

- **Kontributet në natyrë**

o **Vlerësimi:**

- Dallimi mes kontributit në natyrë (dhe mundësisht) sponsorizimit dhe veprimtarisë vullnetare;
- Vlerësimi (rregull i 10% më të ulët se çmimi i tregut apo mallrave/shërbimeve që arrijnë vlerën më shumë se 50,000 Lekë).

Partia "Lëvizja e Re" ka patur kontribute në natyrë në fushatën zgjedhore të datës 06 mars 2022. Këto kontribute kanë qenë për materiale reklamuese dhe për ambjent për zhvillim aktiviteti. Në raportin e paraqitur nga LRE, janë të evidentuara në mënyrë të qartë: statusi i dhuruesit, të dhënat identifikuese të dhuruesit, adresa, vlera e dhurimit, data e dhurimit, nëse është kontribut për zyrat qendrore apo për degët, si dhe përshkrimi i kontributit.

Të gjitha kontributet në natyrë janë në përputhje me kriteret e vendimit nr. 10, datë 24.12.2020, ku përcaktohen rregullat dhe modalitetet për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë ose shërbimeve, huave dhe kredive për qëllime zgjedhore ose politike të përfituara nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore.

Pra, kontributet në natyrë plotësojnë kriterin:

- a) Janë në formë produkti i ofruar pa pagesë.
- b) Vlera e tyre përcaktohet nga dokumentacioni i mbajtur nga përfituesi, në rastin tonë nga LRE
- c) Këto dhurime janë të ardhura që nuk merren në formë monetare
- d) Janë të regjistruara njësoj si dhurimet në para dhe iu është përlllogaritur vlera e tyre monetare
- e) Ato janë paraqitur njëherësh edhe në të ardhura por edhe në shpenzime të fushatës.
- f) Janë llogaritur sipas kushteve të përcaktuara në vendimin nr. 10 datë 24.12.2020.

○ **Kufizimet**

- Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një degë e Partisë;
- Kufizimet (pragu i raportimit dhe deklarimit zbatohet si për kontributet në para ashtu edhe për ato në natyrë- si të garantojmë respektimin e kësaj dispozite kur raportet e financimit të fushatës zgjedhore konsolidojnë llogaritë e selisë së partisë me ato të degëve?)

Pasi i kontrollua lista e dhurimeve në natyrë u pa se nuk ka shkelje në shumën e përgjithme të donacionit nga një donator, pra asnjë donacion nuk i kalon kufijtë ligjor.

Ne kemi kontrolluar dokumentacionin fizik të subjektit. Pasi kemi hartuar tabelat individuale për individ, zyra apo kandidatë, kemi hartuar tabelat e konsoliduara dhe në përfundim të tyre nuk kemi gjetur shkelje të ligjit apo të kriterëve të përcaktuara.

c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike

- **Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë:**
 - Kuotat e anëtarësisë: nuk ka.
 - Botimet – nuk ka;
 - Shtypi i printuar – nuk ka;
 - Dhënie me qira, etj – nuk ka;
- **Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës:**
 - Zyrat qendrore – nuk ka.
 - Degët lokale – kanë vetëm të ardhurat e mbledhura nga kandidatët.



Art-Auditing , për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

- Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruar dhe deklarimit bankar (bank statement ose nxjerrja e llogarisë)

Në lidhje me përputhshmërinë e shumës së të ardhurave dhe deklarimit bankar, nga kontrolli ynë rezultoi se paraqitja e tyre është bërë e saktë.

d/ Huatë/Kreditë – nuk ka.

IV. SHPENZIME

A. PËRMBLEDHJE

Shuma e përgjithshme e raportuar	30.000 lekë
Respektimi i kufirit të shpenzimit (Shuma e shpenzimeve nuk duhet të jetë më shumë se 3 herë më e madhe se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore, në përputhje me nenin 88 të ligjit nr.10019, datë 19.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar)	Shpenzimet e fushatës janë në shumën 30.000 lekë. Fondet publike janë në shumën 0 lekë, trefishi i tyre është 0 lekë. Duke qenë se vlerat janë zero nuk ka vlerë të diksutohet për fondet publike.
Shpenzimet e kryera nga zyra qendrore e Partisë	

(A large blue diagonal line is drawn across the page, likely a signature or a mark.)



Kompleksi Magnet, Tiranë

Rruga Artan Lenja,
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

Art-Auditing, për të ndërtuar besimin!

Media										
Media sociale										
Sondazhe										
Botime/publikime										
Transporti										
Konsulenca										
Reklamime në natyrë										
Shpenzime zyre elektorale										
Shpenzime administrative	10.000	10.000	10.000	10.000						10.000
Shpenzimet zgjedhore										
Shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë										VETEM QENDRA

Art – Auditing
Rruga Artan Lenja, Kompleksi Magnet, Nr.184, Tiranë
Mail: merilika@outlook.com Tel: 069 20 24 448

B. ANALIZA

a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve (është çdo shpenzim që bën një parti ose kandidatët e saj për qëllime të fushatës zgjedhore: Për partitë politike 167.480.250 lekë ndërsa për kandidatët e pavarur 27.913.375 lekë → fokusohuni tek “fushatat e shumëfishta” të bëra në nivel qendror dhe degët e partisë në të gjithë vendin;

- Pasi kontrolluam të gjithë dokumentacionin fizik, (fatura, statement bankar etj) ne vlerësuam se të gjitha shpenzimet e kryera janë në funksion të fushatës për zgjedhjet e pjeshme. Raportet e partisë po ashtu edhe të kandidatëve mbështeteshin mbi dokumente fizike dhe reale, origjinale.
- Fushata ishte e ndarë, selia qendrore nuk kishte të përfshira në kostot e saj shpenzimet e kryera nga kandidatët. Subjekti kishte ndarë mënyrën e kryerjes së shpenzimeve, duke kaluar tek selia qendrore të gjitha shpenzimet të cilat nuk lidhen me shpenzimet e kandidatëve.

b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruar dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

- **Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës :**
 - o Shpenzimet për mitingje: Nuk ka.
 - o Shpenzime për vendin/ambjentin: shpenzimet për ambient zyre janë në total ALL 10.000 lekë. Këto shpenzime janë lekë të shpenzuara nga kandidati për të zhvilluar takimet dhe janë kontribut në natyrë.
 - o Shpenzimet e zbavitjes/argëtimit: nuk ka
 - o Shpenzimet e paisjeve: nuk ka;
 - o Shpenzimet për pijet: nuk ka;
 - o Shpenzimet e reklamave/promocioneve; nuk ka
 - o Shpenzimet e Transportit: nuk ka.
 - o Shpenzimet administrative: nuk ka
- **Materialet promociionale:** në total janë në vlerën 20.000 lekë, janë shpenzime në natyrë për prodhimin e feltëpalosjeve dhe janë shpenzuar nga kandidati
- **Media:**nuk ka.
- **Media sociale:** nuk ka
- **Sondazhe:** nuk ka
- **Botimet/Publikimet:** nuk ka
- **Transporti:** nuk ka
- **Konsulenca:** nuk ka
- **Reklamime në natyrë:** nuk ka
- **Shpenzime zyre elektorale:** nuk ka
- **Shpenzime administrative:** nuk ka

Shpenzimet në mënyrë të përmbledhur janë si tabela në vijim:

Nr	Shpenzime	Qendra	Kandidatët	Totali
1	Materiale promocionale	0	20.000	20.000
2	Mitingje/tubime dhe aktivitete në fushatë	0	10.000	10.000
TOTALI		0	30.000	30.000

V. PËRFUNDIMI

A. SINTEZA

- **Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve për raportimin financiar të fushatës zgjedhore të dt.06 mars 2022 për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë të partisë “Lëvizja e Re”:**

- Natyrën zgjedhore të shpenzimeve të llogaritura dhe të përfshira në raportin e financimit të fushatës zgjedhore: Në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 2 “Përkufizime”, pika 28 , përcaktohet si citoj:

“Shpenzime të fushatës zgjedhore” janë shpenzimet e bëra nga ose në emër të një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët dhe/ose degët e tij, ose të një kandidati të pavarur, të cilat kryhen për të promovuar fushatën e vet ose për të dëmtuar fushatën e një subjekti tjetër, përfshirë kandidatët e tij, pavarësisht datës se kur janë kryer”.

Nisur nga sa më sipër mund të themi se të gjitha shpenzimet e kryera nga subjekti partia politike “Lëvizja e Re” janë shpenzime që i përkasin fushatës zgjedhore, të cilat janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur sipas natyrës së shpenzimit në tabelën më sipër.

- Nuk ka ekzistencë e zbulim të të shpenzimeve të paligjshme si (keqpërdorimi i burimeve publike / blerja e votës). Si rrjedhojë, nuk ka shpenzime, të paligjshme nga natyra për të cilat duhet të llogaritet tejkalimi I kufirit të shpenzimeve për to;
- Nuk ka shpenzime që janë bërë 6 (gjashtë) muaj para datës së zgjedhjeve të cilat do të duheshin të llogariteshin në përcaktimin e tejkalimit të kufirit të shpenzimeve.
- Ka donacione në natyrë të cilat janë në shumën 20,000 lekë, kjo shumë përputhet me shpenzimet në natyrë. Këto donacione në natyrë janë dhënë për zërin “Shpenzime indorekte”. Nga subjekti janë paraqitur veç dhe pas kontrollit tonë rezultoi se ekziston përputhshmëri me donacionet në natyrë.

Gjatë procesit të auditimit nuk kemi gjetje në lidhje me mangësi apo parregullsi.

- **Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit:**
 - Për subjektin Partia “Lëvizja e Re ” nuk kemi hasur parregullsi gjatë procesit të auditimit.
- **Krahasimi me raportin e monitorimit të ekspertëve financiarë:**



Art-Auditing , për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

- Nga kontrolli i shpalljeve të raporteve të monitoruesve në faqen zyrtare të KQZ-së <https://kqz.gov.al/raportet-e-monitoruesve-per-fushaten-zgjedhore-2022/>, ne kontrolluam raportet për Bashkia Dibër ku subjekti Partia Lëvizja e Re ka patur kandidatë si vijon:
 - a) Bashkia Dibër monitorues K.Z , nuk ka shkelje.
 - b) Bashkia Dibër monitorues G.SH: rezultoi se ashtu si kishte raportuar monitoruesi në faqen 18 të raportimit të tij, në këtë qark është zhvilluar një takim në 27 shkurt 2022, edhe subjekti Partia LRE, ka deklaruar, në raportimet e kandidatëve, shpenzime për një takim

B. PËRFUNDIMI

Çertifikimi/dhënia e opinionit pa rezervë

Ne kemi audituar raportin financiar tip standart të fushatës zgjedhore për zgjedhjet pjesore vendore të datës 06 mars 2022, të cilat përfshijnë të ardhurat e përfituara dhe të gjitha shpenzimet e kryera nga partia politike "Lëvizja e Re", për periudhën 6 muaj përpara deri në ditën e plotësimit të tij.

Sipas opinionit tonë, raporti financiar bashkëlidhur paraqet drejt në të gjitha aspektet materiale shpenzimet e të ardhurat e raportuara për fushatën zgjedhore nga partia politike "Lëvizja e Re", për fushatën zgjedhore për zgjedhjet pjesore vendore të datës 06 mars 2022.

Baza për opinionin

Ne kryem procedurat për auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit. Ne jemi të pavarur nga subjekti zgjedhor në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave, raporteve financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme për të dhënë një bazë për dhënie të opinionin tonë pa rezerva.

AUDITUESE LIGJORE


MERI LIKA
NUIB : L 41528005 F
Tiranë - Albania

Tiranë, më 15 shtator 2022



Shtojcë e raportit të audituesit

Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.
- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.
- Ne lexojmë dhe të vlerësojmë informacionet e tjera, për arsye se informacionet e tjera mund të kenë inkoherenca (mospërputhje) materiale me pasqyrat financiare ose me njohjen e siguruar nga audituesi gjatë auditimit, mund të tregojnë se ka një anomali materiale në pasqyrat financiare ose që ekziston një anomali materiale në informacionet e tjera, ku çdonjëra prej tyre mund të dëmtojë besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe të raportit të audituesit mbi këto pasqyra. Këto anomali materiale mund të influencojnë në mënyrë të papërshtatshme vendimet e përdoruesve për të cilët është përgatitur raporti i audituesit.